



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria-Vlada-Gouvernement*

02/10  
Datë: 10.02.2010

Duke njohur faktin që procedurat tenderuese për Partneritetin Publiko Privat të njohur si projekti “Kosova e Re” ishin materialisht të avancuara para dhe mbas datës 25 Qershor 2009, dhe ka vazhduar pa ndërprerje deri në atë datë, Komiteti Drejtues i Projektit “Kosova e Re”, në mbledhjen e mbajtur me datë 10 Shkurt 2010, duke marrë parasysh komentet e pranuar gjatë Konferencës së Investitorëve të mbajtur me 20 dhe 21 Janar 2010, dhe pas rekomandimeve të Këshilltarëve të Transaksionit me qëllim të arritjes së numrit sa më të madh të ofertuesve, morri këtë:

**VENDIM**

1. Kriteret minimale të Para-kualifikimit të përshkruar në Memorandumin e Para-kualifikimit të aprovuar me 18 Dhjetor 2009 nga Komiteti Drejtues i Projektit “Kosova e Re” ndryshohen në kriteret e Memorandumit të Para-kualifikimit të bashkangjitur në Shtojcën A.
2. Afati i dorëzimit të “Shprehjes së Interesit” bazuar në “Memorandumin e Para-kualifikimit” të miratuar me 18 Dhjetor 2009 nga Komiteti Drejtues i Projektit “Kosova e Re” dhe i zgjatur me Vendimin 01/10 të Komitetit Drejtues të Projektit të datës 21 Janar 2010, mbetet e pandryshuar, gjegjësisht deri me 26 Shkurt 2010, ora 17:00.
3. Zyra e Projektit PATEL obligohet të Njoftojë dhe Publikojë shpalljen, duke përfshirë deklaratën për shtyp.
4. Vendimi hyn në fuqi datën e nënshkrimit të tij.

Justina SHIROKA – PULA

Kryesuese e KDP-së

Kopje për:

- Anëtarët dhe Vëzhguesit e Komitetit
- Drejtues të Projektit
- Zyra e Projektit PATEL
- Arkivit të MEM-it

## Shtojca A

KDP-ja tani fton aplikantët e kualifikuar të tregojnë interesimin e tyre për të zbatuar Projektin. Për t'u marrë parasysh si aplikant për hyrje në listën e ngushtë të ofertuesve të para-kualifikuar, Shprehjet e Interesit, në gjuhën angleze, të këtyre ofertuesve duhet të përmbajnë informata mbi kualifikimet e tyre në hollësi të mjaftueshme për t'i mundësuar KDP-së të vlerësojë aftësinë e firmës apo konsorciumit për të zhvilluar Projektin sipas kërkesave të përcaktuara nga KDP-ja. Nëse një palë e interesuar ka përvojë të pamjaftueshme në një fushë të caktuar, mundet dhe inkurajohet të lidhet me të tjerë për të avancuar kualifikimet e veta. Pikat në vijim do të përdoren për vlerësimin e kualifikimeve:

- a. Aplikanti mund të jetë subjekt i vetëm apo konsorcium. Pasi të ketë hyrë në listën e ngushtë, struktura e anëtarësisë që përdoret për kualifikim nuk mund të ndryshohet pa miratimin paraprak me shkrim të KDP-së.
- b. Për vlerësimin e përvojës dhe aftësive teknike të një konsorciumi, përvoja dhe aftësitë teknike të secilit anëtar do të kombinohen në vlerësim. Megjithatë, përvoja dhe resurset e nënkontraktorëve të aplikantit do të merren parasysh në vlerësimin e përputhshmërisë së aplikantit vetëm me kriteret e kualifikimit (d.iii) dhe (d.iv) si më poshtë.
- c. Secili anëtar i konsorciumit inkurajohet të ofrojë aftësinë e tij financiare ndaras, për vlerësim.
- d. Ofertues i para-kualifikuar do të jetë ai që arrin apo tejkalon kriteret e kualifikimit të dhëna si më poshtë. Ofertuesi duhet të demonstrojë përvojën e tij në kontraktimin, financimin, menaxhimin, inxhinieringun, prokurimin, ndërtimin dhe operimin e projekteve të natyrës dhe kompleksitetit të ngjashëm me Projektin e propozuar. Kriteret në vijim do të përdoren në vlerësim për qëllime të para-kualifikimit:
  - (i) **Kapaciteti financiar:** Aplikanti, ose stafi shoqëruar i lartë menaxherial, duhet të demonstrojë kapacitetin financiar për të financuar, apo përvojë në rregullimin e financimit, për investimin e kërkuar për një minierë të madhe sipërfaqësore dhe një central energjetik (me vlerë mbi 1 miliardë euro). Ju lutem përshkruani gjitha projektet e gjenerimit të energjisë dhe projektet e minierave sipërfaqësore gjatë 15 viteve të fundit, në të cilat aplikanti, ose stafi i lartë menaxherial, ka investuar, duke dhënë lokacionin e qartë, vitin e përmbylljes financiare, shumën totale të kapitalit, shkallën e borxhit, si dhe rolin e shumën e investuar nga aplikanti.
    - o **Minimumi për para-kualifikim:** Aplikanti do të ofrojë fakte që ai (ose stafi i lartë menaxherial), nëse nuk është konsorcium, ose anëtari udhëheqës nëse është konsorcium, ka rregulluar financimin për një ose më shumë projekte të energjisë dhe/ose projekte të minierës me vlerë të financimit (borxhi plus kapitali rrjedhës) prej së paku 800 milionë euro. Në rast se propozohet të merret në konsideratë ekspertiza e stafit të lartë menaxherial nga kompanitë apo entitetet tjera, për të përmbushur standardin e Kapacitetit Financiar, atëherë duhet ofruar fakte për të demonstruar përvojën e stafit të lartë menaxherial në aranzhimin e financimit në vlerë prej së paku 1 miliard EUR në total.
  - (ii) **Menaxhimi dhe sponsorimi i Projektit:** Aplikanti duhet të demonstrojë që ka kapacitetin për të menaxhuar me sukses kontraktimin, financimin, dizajnimin, inxhinieringun, prokurimin, ndërtimin, futjen në funksion, operimin dhe rikultivimin e një miniere të madhe sipërfaqësore dhe një termocentrali me linjit. Ju lutemi përshkruani gjitha projektet e gjenerimit të energjisë dhe gjitha projektet e minierave (sipërfaqësore dhe nëntokësore) gjatë 15 viteve të fundit në të cilat aplikanti ka pasur rol menaxhimi, duke dhënë qartë madhësinë (gjithë kapacitetin) e projektit, lokacionin, vitin e përfundimit të ndërtimit, si dhe nëse aplikanti ka qenë udhëheqës apo vetëm pjesëmarrës.
    - o **Minimumi për para-kualifikim:** Aplikanti do të ofrojë fakte që ai ka menaxhuar zhvillimin e (A) një apo më shumë miniere me kapacitet prej së paku 8 milionë ton/vit thëngjill apo linjit ose ka prodhuar mesatarisht 5 milion tonelata thëngjill apo

linjit në vit gjatë periudhës 5 vjeçare në 15 vitet e fundit dhe (B) një apo në shumë projekte energjetike me djegie të thëngjillit apo linjitet me kapacitet bruto të gjenerimit të energjisë elektrike prej së paku 600 MW.

(iii) **Ndërtimi:** Aplikanti duhet të demonstrojë që ai (apo nënkontraktorët e tij të ndërtimit) kanë përvojën nga e kaluara në projektimin, prokurimin dhe ndërtimin e suksesshëm të minierës sipërfaqësore ose nëntokësore të thëngjillit apo linjitet dhe centralit të gjenerimit të madhësisë si në pikën (ii) më lart. Ju lutem përshkruani gjitha (por të mos tejkalohet numri prej 10 projekteve të minierave dhe 10 projekteve për centrale të gjenerimit) projektet relevante të minierave (prej të cilave duhet të ketë së paku një shembull të minierës sipërfaqësore) dhe centralet e gjenerimit në të cilat aplikanti (apo nënkontraktorët e tij) ka qenë ndërtues udhëheqës, duke qartësuar madhësinë (gjithë prodhimin) e projektit, lokacionit, vitit të përfundimit të ndërtimit, teknologjisë dhe prodhuesve të pajisjeve të mëdha.

- o **Minimumi për para-kualifikim:** Aplikanti do të ofrojë fakte që ai (ose nënkontraktorët e ndërtimit të tij) ka shërbyer si subjekt udhëheqës ndërtimi në së paku dy projekte të ngjashme për nga natyra dhe kompleksiteti me Projektin, që janë kompletuar dhe operuar me sukses për së paku 18 muaj;

(iv) **Operimi dhe mirëmbajtja:** Aplikanti duhet të demonstrojë që ai (apo nënkontraktorët e tij të operacioneve) ka përvojën të operojë dhe mirëmbajë një minierë sipërfaqësore si dhe të operojë e mirëmbajë një central energjetik të madhësisë si tek pika (ii) më lart. Nëse operatori është nënkontraktor, kontrata duhet të jetë së paku 5 vjet. Ju lutemi përshkruani gjitha (por të mos tejkalohet numri prej 10 projekteve për miniera (sipërfaqësore dhe nëntokësore) dhe 10 për centrale) kontratat relevante të OeM-së në të cilat operatori(ët) e propozuar kanë hyrë në 15 vitet e fundit, duke qartësuar lokacionin, kohëzgjatjen e kontratës, madhësinë, dhe teknologjinë e secilës kontratë.

- o **Minimumi për para-kualifikim:** Aplikanti do të ofrojë fakte që ai (ose nënkontraktori i tij kryesor i operacioneve) ka (A) operuar në kontinuitet prej vitit 2004 minierë sipërfaqësore me prodhim së paku 5 milionë tonë/vit për së paku 1 vit dhe (B) ka operuar termocentrale me kapacitet prej së paku 2000MW (në një lokacion të vetëm apo kapacitete agregate në disa lokacione) për së paku 3 vjet që prej vitit 2004.

e. Kualifikimet minimale të secilit aplikant do të vlerësohen në bazë të qasjes KALON/NUK KALON.

Dokumentet qartësisht duhet të shprehin organin apo firmën udhëheqëse, marrëdhënien e saj me kompaninë amë (nëse ka), si dhe firmat tjera që përbëjnë konsorciumin apo sipërmarrjen e përbashkët. Secili aplikant do të ofrojë një deklaratë nga secili anëtar i konsorciumit që anëtari udhëheqës është i autorizuar të veprojë në emër të tyre, si dhe që anëtari udhëheqës do të jetë pika e kontaktit për secilin konsorcium. Gjithë anëtarët e konsorciumit do të obligohen të marrin pjesë gjatë gjithë afatit të Projektit, përveç nëse kepet miratimi paraprak i KDP-së. Emri, adresa postare, numrat e telefonit dhe faksit, si dhe adresa elektronike e menaxherit të projektit të aplikantit me të cilin do të bëhet e gjithë korrespondenca në lidhje me Projektin do të ofrohen si informata në dokumente.

KDP-ja ka për qëllim të shfrytëzoj sistemin e bazuar në pike, të publikuar më herët, me qëllim të krijimit të listës së ngushtë, për të arritur numrin e arsyeshëm të aplikuesve me kualifikimet më të mira.